

Komunikatë për medie

Të moshuarit e Prizrenit angazhohen për më shumë gjelbërim

Në performansën “Më shumë gjelbërim në hapësirat publike” të organizuar nga EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës...”, të financuar nga Olof Palme International Center (OPIC), e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë, të mërkurën, komuniteti i të moshuarve të Prizrenit ka intervenuar me mbjelljen e fidanëve në Kejin përballë Xhamisë së Sinan Pashës, që ishte identifikuar nga ta si një hapësirë publike pa gjelbërim të mjaftueshëm.

Përmes këtij aktiviteti, në mënyrë publike është adresuar kërkesa që gjatë planifikimit dhe investimeve të komunës në hapësirat publike, t’i kushtohet kujdes më i madh gjelbërimit, me qëllim që këto pika më pastaj të shërbejnë për ndërveprim më të madh ndërmjet grupmoshave të ndryshme të qytetarëve dhe njëkohësisht të krijohet një afërsi me mjedisin.

Gjatë ditës, komuniteti i të moshuarve, të ndihmuar edhe nga të rinjtë vullnetarë kanë mbjellë lule dhe kanë mbëltuar fidane në elementet e improvizuara urbane, për ti dhënë një pamje tjetër Kejit në fjalë, sikurse që janë vendosur edhe tavolinat për lexim.

Vizioni për këtë intervenim ka dalë nga punësoria me të moshuarit, të mbajtur gjatë javës së kaluar, ku janë zhvilluar idetë për ridizajnimin e kësaj hapësire publike, me qëllim që ti shërbej më mirë nevojave të komunitetit.

“Qyteti gjithëpërfshirës...” është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje të ndryshme të qytetit dhe paralelisht zhvillohet edhe procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Me respekt,

Fisnik Minci, koordinator projekti

OJQ EC Ma Ndryshe

Saraçët 5, 20000 Prizren

Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-5, 10000 Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

+377 44 289 132

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë



OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771